



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ERZ" Sh.P.K. të datës 25.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ERZ" Sh.P.K. të datës 25.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.**
- II. DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "ERZ" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Bujar I. Kabashi" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 25.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se disa nga kërkesat e dosjes së tenderit nuk janë në përputhje me paramasën dhe parallogarinë dhe si të tilla nuk i shërbejnë qëllimit të aktivitetit të prokurimit. Në këtë mënyrë parashtruesi pretendon se këto kërkesa mund të manifestojnë shkelje të parimit për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Në këtë drejtim parashtruesi kërkon që të largohet kërkesa për një inxhinier të mjedisit pasi që nuk janë përshkruar karakteristikat mjedisore në asnjë pikë të paramasës dhe parallogarisë. Po ashtu është kërkuar që të largohet kërkesa për një inxhinier të gjeologjisë pasi që në asnjë pozicion të paramasës dhe parallogarisë nuk është paraparë që të bëjnë matjet gjeologjike. Po ashtu është kërkuar që të largohet edhe kërkesa për një punëtor të trajnuar për organizimin e kantierit pasi që funksionin e njëjtë e përmbushë edhe menaxheri i projektit ose inxhinieri i ndërtimitarisë drejtimi konstruktiv prandaj kjo kërkesë është e panevojshme. Po ashtu është kërkuar që të largohet kërkesa për dy teknik të ndërtimitarisë – punues metali të kualifikuar nga shkollat e mesme profesionale me titullin teknik, pasi që funksionin e njëjtë e përmbush tekniku i makinerisë. Parashtruesi ka kërkuar po ashtu që të ndryshohet/plotësohet ose të largohet kërkesa prej 15 punëtorëve të profileve të ndryshme. Parashtruesi ka kërkuar po ashtu të largohen edhe disa kërkesa për pajisje në aneksin 7 të dosjes së tenderit konkretisht kërkesa nr. 4, 5, 6, 7, 10, 11, 20, 22, 24 dhe 25 pasi që këto kërkesa janë të panevojshme duke qenë se nuk janë në përputhje me paramasën dhe parallogarinë dhe si të tilla nuk i shërbejnë qëllimit të aktivitetit të prokurimit në kuptim të nenit 1 të LPP mirëpo mund të konsistojnë edhe shkeljen e parimit për mos diskriminim/favorizim sipas nenit 7 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 29.08.2023 njësia kërkuuese ka dërguar përgjigjet ashtu që ka udhëzuar të bëhen ndryshim/plotësimet e dosjes së tenderit sipas nevojës në përputhje me LPP.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit ka gjetur se një numër i konsiderueshëm i kërkesave të dosjes së tenderit nuk janë në përputhje të plotë me paramasën dhe parallogarinë. Rrjedhimisht ato duhet të riformulohen duke marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit ashtu që të evitohet çdo mundësi për të vepruar në kundërshtim me parimet themelore të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.